

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“MASTER LEGAL CONSULTING” SH.P.K

Sot, më datë 12.07.2024, unë i nënshkruari:

Eno Seferi, datëlindja 14.04.1984 lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal I40414072V;

bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” vendosa të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**MASTER LEGAL CONSULTING**” sh.p.k, sipas parashikimeve të mëposhtme:

NENI 1
Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është “**MASTER LEGAL CONSULTING**” sh.p.k.

NENI 2
Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Farkë, Rruga “Ullishta”, Pallati Primavera, Kati 1, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë.

NENI 3
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj me karakter thelbësor shërbimet juridike, civile, penale, administrative.

Këshillime dhe asistencë ligjore për personat fizike a juridike, vendas e të huaj në të gjitha fushat e së drejtës, përfshirë ketu edhe hartimin e çdo dokumentacioni ligjor, përfshirë ketu edhe hartimin e kontratave; Përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të personave fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, privatë apo publikë për çdo procedim administrativ, gjyqësor, jashtëgjyqësor, ekezekutimi të vendimeve gjyqësore etj. konform rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, përpara Gjykatave Administrative të Shkallëve të Para, Gjykatën e Apelit Administrativ, Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm në të drejtën civile dhe penale, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë; Përfaqësime ligjore në të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë. Të marrë pjesë në projekte që kanë si qëllim njohjen dhe implementimin e legjislacionit ndërkombëtar e veçanërisht atij të BE në legjislacionin e brëndshëm në kuadrin e procesit të integritimit euroatlantik të vendit; Të marrë pjesë në projekte që kanë si qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe të ndihmojë nëpërmjet trajnimeve juristë dhe ekspertë të fushave



përkatëse në njohjen, interpretimin dhe zbatimin e akteve normative; në përmirësimin e legjislacionit në përgjithësi dhe atij të organizimit e funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë në veçanti; Përgatitje e të gjitha llojeve të dokumentacionit të përshtatshëm në realizimin e përfaqësimit para çdo organi hetimor dhe gjyqësor, administratës qendrore apo vendore në çdo lloj proçedimi civil, penal dhe administrativ. Përgatitjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative për licencimin dhe administrimin juridik të Kompanive Shqiptare dhe të Huaja private gjatë gjithë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Të ndihmojë dhe asistojë subjektet e biznesit në zgjidhjen e mosmarrveshjeve me pajtim, duke u bërë të njohura edhe praktikat ndërkombëtare të arbitrazhit, për zgjidhjen e konflikteve tregtare.

Asistimin ligjor për krijimin, rregjistrimin, ndjekjen, në kohë të subjekteve juridike të të gjitha formave parashikuar nga legjislacioni shqiptar.

Asistencë ligjore, përpilim dokumentacioni, nxjerrje aktesh administrative të nevojshme; Bashkëpunim me një rreth të gjerë profesioneve të të gjitha llojeve si: noterë, ekspertë të fushave të ndryshme (kontabël, topograf, ndërtimi, vlerësues, përkthyes, etj); Bashkëpunim me avokatë, zyra avokatie apo çdo lloj forme tjetër organizimi, brenda apo jashtë vendit.

Administrim pasurish, Real Estate. Shoqëria mund të financohet nga shoqëri private vëndase dhe të huaja.

NENI 4 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, me vlerë 100,000 (njëqind mijë) LEKË. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë:

Ortaku themelues Eno Seferi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (njëqind mijë) LEKË, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortakut themelues në llogarinë bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e mandat pagesës bankare të shlyerjes së kapitalit themeltar nga ana e Ortakut të Shoqërisë, depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklaram vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

NENI 5 **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 **Organet Drejtuese**

Ne zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :



1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj i cili është **Eno Seferi** atësia Valter, i datëlindjes 14.04.1984, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal I40414072V.

NENI 7 **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.
Me nënshkrimin e këtij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet që të hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e të cilit do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që të kryejë procedurat e Rregjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, Administratori mund ta kryejë personalisht, ose me anë personave të caktuar prej tij me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

Ortaku Themelues

Eno SEFERI

